



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 8/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj duke vendosur me apelin e parashtrueses Marija Simanovic, kundër vendimit të Komisionit Qendror për Zgjedhje KQZ-së nr.717/2017 lidhur me tërheqjen nga lista si kandidatë për deputetë nga subjekti politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS) me seli në Shtërpce për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me 11.06.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 26.05.2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. **PRANOHET** apeli si i bazuar i Marija Simanovic, lidhur me tërheqjen nga lista e kandidatës për deputetë nga Progresivna Demokratska Stranka (PDS) Shtërpce.
- II. **ANULOHET** vendimi i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve KQZ nr. 717/2017 i datës 24.05.2017 lidhur me certifikimin e kandidatës Marija Simanovic .

Arsyetim

Me datën 25.05.2017 PZAP-i ka pranuar një apel nga Marija Simanovic, për tërheqjen nga lista si kandidat për deputet në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS) Nenad Rasic në të cilën kërkojë që të tërhiqen nga lista për arsye personale pasi siç pretendon ajo emri i saj gjendet në këtë listë për deputet kundër vullnetit të saj. Parashtruesja e ka njoftuar subjektin e saj politik përkatës për shkak të është kundër vullnetit të saj dhe nëpërmjet kësaj kamë dëshmuar se nuk kamë pranuar vullnetarisht që të jem në këtë listë.

PZAP-i, pas pranimit të apelit në kuptim të nenit 11 paragrafi 7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datën 25.05.2017, e ka informuar KQZ-në dhe ka kërkuar

nga ky komision që deri me datën 25.05.2017 brenda afatit të caktuar të përgjigjet lidhur me apelin e parashtruar.

Lidhur me këtë PZAP-i e informoi KQZ-në për apelin e ushtruar ndaj vendimit të saj dhe kërkoi nga KQZ-ja që të përgjigjet deri me datë 25.05.2017, me të njëjtën datë KQZ-ja përgjigjet se në baze të nenit 28.1 të LZP-së tërheqja apo zëvendësimin i kandidatëve dhe subjekteve politike mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ një njoftim me shkrim për tërheqje jo më vonë se dy ditë të punës para datës së caktuar për tërheqjen e shortit të përcaktuar sipas nenit 24.1 të LZP-së. Në përgjigje në ankesë theksohet se KQZ në mbledhjen e mbajtur me datën 24.05.2017 ka marrë vendim me nr. të protokollit 717/2017 ku është caktuar qe data e hedhjes së shortit të bëhet me datën 26.05.2017 ku sipas KQZ, parashtruesja e apelit kërkesën për tërheqje ka paraqitur me datën 25.05.2017 dhe bazuar në nenin 28.1 të LZP –së e njëjta nuk mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor .

PZAP-i pasi shqyrtoj dhe analizoj shkresat e lëndës gjeti se:

Apeli është i bazuar:

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me LZP-së konkretisht me nenin 28.1 të LZP-së, ku përcaktohet se: “subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar kërkesën KQZ-së, për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit”.Paneli vlerëson ku sipas kësaj dispozite apeli i parashtruar nga ana e kandidatës Marija Simanovic është paraqitur brenda afatit kohor dhe se ndryshimi i datës së hedhjes së shortit nga ana e KQZ-së, nuk mund të jetë në dëm të kandidatës .

Paneli konstaton se pretendimet ankimore të parashtrues janë të bazuar pasi që neni 122.1 pika c i LPZ-së përcakton se kandidati pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në procesin zgjedhor dhe mund të parashtrtoj apel në PZAP. Andaj mbi këtë baze paneli konstaton se apeli është i bazuar duke marrë parasysh se kandidatja për deputet Marija Simanovic nuk dëshiron qe të jete pjese në listat zgjedhore kundër vullnetit të saj për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Andaj në baze të nenit 122.1 pika c si dhe nenit 118.1 të LPZ , u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 8/2017 më datën 26.05.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*